

Imigrimi në Gjermani me qëllim të punësimit: Rregullorja e Ballkanit Perëndimor dhe Ligji mbi imigrimin e fuqisë punëtore

Tani keni dy mundësi për të hyrë në Gjermani me qëllim të punësimit:

1. Për shtetasit e Shqipërisë, Bosnje-Hercegovinës, Kosovës, Maqedonisë, Malit të Zi dhe Serbisë ekziston e ashtuquajtura "Rregulli i Ballkanit Perëndimor". Ky ka një afat deri në fund të vitit 2023. Sipas rregullores, Agjensia Federale e Punësimit me provimin e përparësisë "Vorrangprüfung" (nga 1 Mars 2020) mund të aprovoj ushtrimin e çdo pune. Sidoqoftë, ju nevojitet një kontratë pune ose një ofertë e detyrueshme pune. **Njohja e kualifikimit tuaj nuk është një kusht për këtë.** Në qoftë se punoni në një profesion të rregulluar (p.sh. mjek), atëherë kualifikimi juaj duhet ende të njihet. Për shkak të kërkesës së lartë, ambasadat gjermane në vendet e përmendura aktualisht kanë kohë pritje për aplikime vizash prej më shumë se një viti.

2. Ju mund të ndiqni imigrimin përmes "Ligjit të ri rreth imigrimit të fuqisë punëtore të kualifikuar", i cili do të hyjë në fuqi më 1 Mars, 2020. **Përveç një oferte specifike për punë, ju duhet edhe njohja e kualifikimit tuaj për aplikimin e vizës.** Në kushte të caktuara, ju mund gjithashtu të hyni në Gjermani për të kërkuar punë. Sidoqoftë, është e rëndësishme që së pari të njihni kualifikimin tuaj të huaj nga organi përgjegjës në Gjermani. Ju mund të aplikoni nga jashtë. Më shumë informacion mbi procedurën e njohjes dhe organin tuaj përgjegjës mund të gjeni këtu: www.anerkennung-in-deutschland.de/finder

Ju mund të aplikoni për njohjen e kualifikimit tuaj përpara 1 Marsit. Sidoqoftë, ju mund të bëni një takim në Ambasadën Gjermane për vizë pasi të keni marrë njohjen e gradës ose kualifikimit profesional nga Gjermania. Kjo zakonisht zgjat disa muaj. Nëse kualifikimi juaj nuk është njohur plotësisht, ju keni mundësinë për të përfunduar masa të kualifikimit në Gjermani në mënyrë që të merrni njohjen e plotë.

Ne dëshirojmë të nënvizojmë një procedurë të re të krijuar nga ligji, të ashtuquajturat "beschleunigtes Fachkräfteverfahren" (Procedura e përshpejtuar për punëtore të kualifikuar), në të cilën punëdhënësi juaj i ardhshëm në Gjermani mund të fillojë procedurën pranë autoriteteve kompetente të imigracionit kundrejt një tarife të veçantë. Kjo procedurë shoqërohet me kohë të shkurtra të përpunimit për autoritetet e përfshira, duke përfshirë edhe zyrat e vizave.

Këtu do të gjeni informacione të dobishme për hyrjen në Gjermani me ane të ligjit të ri mbi imigrimin: <https://www.make-it-in-germany.com/en/visa/kinds-of-visa/work/skilled-immigration-act/>